



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim Simultan (A-B/B-A) 1

Ngarkesa: 40 kredite, 40 orë mësimorësh në klasë, 10 leksione, 30 seminare

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor Përkthim dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore; T'u japë studentëve njohuri teorike dhe praktike mbi interpretimin e konferencave, me fokus në teknikat dhe modelet më të rëndësishme të fushës. T'i aftësojë studentët për të interpretuar në mënyrë profesionale konferenca nga fusha të ndryshme, duke aplikuar teknika të interpretimit simultan dhe të atij me fletë. Të nxisë zhvillimin e aftësive analitike, përpunuese dhe parashikuese në kuptimin dhe transmetimin e mesazheve gjatë interpretimit. Të përgatisë studentët për kërkime të mëtejshme akademike dhe profesionale në fushën e interpretimit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me teknikat dhe procedurat bazë të interpretimit simultan dhe të interpretimit me fletë.
2. Të trajtojë, si në planin teorik, ashtu edhe në atë praktik, fenomene gjuhësore, leksikore, stilistike dhe gramatikore në varësi të natyrës së tekstit dhe stilit funksional.
3. Të aftësojë studentët në zbërthimin e saktë të mesazheve si bazë për interpretim cilësor.
4. Të zhvillojë aftësinë për të përdorur njohuritë nga stilistika, leksikologjia dhe gramatika në procesin e interpretimit.

Rezultatet e pritshme : Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Zbatojnë teknikat kryesore të interpretimit simultan dhe me fletë, në kontekste të ndryshme tematike dhe profesionale.
2. Analizojnë dhe zbërthejnë me saktësi tekstet e folura, duke identifikuar strukturën, qëllimin dhe elementët thelbësorë të mesazhit.
3. Përdorin me efikasitet njohuritë gramatikore, leksikore dhe stilistike në procesin e interpretimit në kohë reale.
4. Kuptojnë dhe interpretojnë saktë idiomat, nuancat gjuhësore dhe qëllimin e folësit, duke siguruar ekuivalencë komunikative dhe kulturore.